

NDALOHET SHPËRNDARJA DERI MË: 14 maj 2024, ora 06:00 CET

Shtimi i ngacmimeve dhe dhunës kundrejt personave LGBTIQ

Në Evropë, është rritur numri i personave LGBTIQ që e shprehin hapur orientimin e tyre. Në të njëjtën kohë, ata përballen me një nivel më të lartë dhune, ngacmimi dhe bullizmi sesa më parë. Kjo vlen në veçanti për të rinjtë LGBTIQ, të cilët janë veçanërisht të cenueshëm. Këto janë disa prej gjetjeve të anketimit më të fundit të Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore (FRA), bazuar në përgjigjet e mbi 100 000 personave LGBTIQ në mbarë Evropën.

Raporti "[LGBTIQ equality at a crossroads: progress and challenges](#)" (Barazia e personave LGBTIQ në udhëkryq: progresi dhe sfidat) pasqyron përvojat, pikëpamjet dhe sfidat me të cilat përballen personat LGBTIQ në Evropë. Gjithashtu, ai nënvizon ndryshimet krahasuar me anketimet e mëparshme të FRA-së, përkatësisht në vitet [2019](#) dhe [2012](#).

Gjetjet dëshmojnë shenja të një progresi të ngadaltë, por gradual. Edhe pse diskriminimi kundrejt personave LGBTIQ mbetet i lartë, vihet re një rënie graduale. Shkollat i trajtojnë problematikat e lidhura me personat LGBTIQ në mënyrë më pozitive dhe më proaktive dhe të rinjtë ndihen më të mbështetur nga mësuesit dhe bashkëmoshatarët e tyre. Megjithatë, bullizmi, ngacmimi dhe dhuna kanë arritur në nivele të larta.

Në gjetjet kryesore të anketimit përfshihen:

- **Pranimi:** më tepër se 1 në 2 persona e pranojnë hapur tashmë orientimin seksual, identitetin dhe shprehjen gjinore, si dhe karakteristikat e tyre të seksit. Megjithatë, shumica prej tyre vazhdojnë të mos kapen përdore në publik me partnerin e tyre të të njëjtit seks sepse u tremben sulmeve të mundshme.
- **Diskriminimi:** më tepër se 1 në 3 persona përballen me diskriminim gjatë jetës së tyre të përditshme për shkak të kategorisë ku bëjnë pjesë. Kjo përbën një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2019 (2 në 5 persona). Gjithsesi, diskriminimi mbetet i padukshëm pasi vetëm 1 në 10 persona i raportojnë incidentet.
- **Dhuna:** më tepër se 1 në 10 persona kanë përjetuar dhunë në 5 vitet para anketimit, një nivel ky pak më i lartë krahasuar me vitin 2019. Më tepër se 1 në 3 persona interseks janë sulmuar.
- **Ngacmimi:** më tepër se 1 në 2 persona kanë qenë viktimat të ngacmimit të motivuar nga urretja, çka përbën rritje krahasuar me 1 në 3 persona në vitin 2019. 2 në 3 persona interseks dhe trans janë ngacmuar.
- **Bullizmi:** më tepër se 2 në 3 persona shprehen se janë bullizuar në shkollë dhe ky bullizëm ka ndodhur tek të gjithë brezat dhe në të gjitha vendet e BE-së. Kjo përbën një rritje të lartë krahasuar me vitin 2019 (1 në 2 persona).

- **Arsimi:** shkollat i trajtojnë problematikat e lidhura me personat LGBTIQ më shpesh se më parë. Më tepër se 1 në 5 nxënës LGBTIQ shprehen aktualisht se shkollat ku studiojnë i trajtojnë me pozitivitet problematikat e tyre.
- **Shëndeti mendor:** më tepër se 1 në 3 persona e kanë menduar vetëvrasjen. Më tepër se gjysma e personave trans, me gjini jo-binare dhe me variancë gjinore, shprehen se kanë mendime vetëvrasjeje.
- **Praktikat e "konvertimit":** 1 në 4 persona deklarojnë se kanë qenë të detyruar t'u nënshtrohen praktikave të konvertimit për të ndryshuar orientimin e tyre seksual ose identitetin dhe shprehjen gjinore.
- **Qeveritë:** Vetëm 1 në 4 persona mendojnë se qeveritë e tyre po i luftojnë aspektet e paragjykitimit dhe intolerancës kundrejt personave LGBTIQ, krahasuar me 1 në 3 persona në vitin 2019.

Raporti nënvizon gjithashtu se përvojat e personave LGBTIQ variojnë ndjeshëm në vende të ndryshme të BE-së dhe secili grup përballet me sfida të ndryshme.

Personat interseks, trans, me gjini jo-binare dhe me variancë gjinore përballen me më tepër ngacmim dhe dhunë. Ata kanë më tepër gjasa që të përballen me probleme të shëndetit mendor dhe të kenë mendime vetëvrasjeje. Gjithashtu, ata kanë më tepër gjasa që të mbeten të pastrehë dhe të kenë vështirësi për të aksesuar shërbimet e kujdesit shëndetësor. Kjo vlen gjithashtu edhe për personat LGBTIQ me aftësi të kufizuara, në vështirësi financiare ose anëtarë të grupeve të caktuara etnike, racore apo anëtarë të pakicave të tjera.

Gjetjet e anketimit do të mbështesin Komisionin Evropian për të vlerësuar [Strategjinë e Barazisë për LGBTIQ](#) dhe do të ndihmojnë në avancimin e politikave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të personave LGBTIQ. FRA u bën thirrje qeverive që të marrin masa në aspektet në vijim:

- **Krimet e urrejtjes:** të zbatohet një kulturë "zero tolerancë" ndaj dhunës dhe ngacmimit të personave LGBTIQ. Të investohet në trajnimin e policisë për të garantuar që të jenë në gjendje të identifikojnë, regjistrojnë dhe hetojnë siç duhet krimet e urrejtjes kundër personave LGBTIQ, me qëllim që viktimat të ndihen të sigurta për të raportuar sulmet dhe të trajtohen në mënyrë të drejtë. Të konsiderohen krimet e motivuara nga paragjykimi si faktorë rëndues gjatë procedurave penale.
- **Diskriminimi:** të trajtohet diskriminimi në të gjitha fushat duke miratuar direktivat e BE-së, përkatësisht Direktivën për Trajtim të Barabartë dhe Direktivën për Standardet për Organet e Barazisë. Të fuqizohen dhe të pajisen me burimet e nevojshme organet e barazisë në mënyrë që të mund të ofrojnë mbështetje më të mirë për viktimat.
- **Urrejtja online:** të trajtohen fushatat e keqinformimit dhe të urrejtjes online kundër personave LGBTIQ. Të trajtohet rreziku i paragjykimit në algoritma, si dhe përgjegjësia e platformave dixhitale sipas legjislacionit të BE-së.
- **Arsimi:** të kthehen shkollat në ambiente të sigurta dhe mjedise mësimore mbështetëse për të gjithë fëmijët. Të trajtohet bullizmi dhe të garantohet se kurrikulat dhe sistemet arsimore mbështeten në praktikat më të mira të promovuara nga BE-ja.

- **Kujdesi shëndetësor:** të garantohet akses në kujdes shëndetësor cilësor, si dhe mbështetje për shëndetin mendor. T'u jepet fund praktikave të "konvertimit" dhe ndërhyrjeve mjekësore që nuk janë jetike.

Citim nga Drejtorja e FRA-së [Sirpa Rautio](#): "Në Evropë, shprehja hapur e identitetit si person LGBTIQ nuk duhet të përbëjë problem. Edhe pse vërejmë shenja progresi, bullizmi, ngacmimi dhe dhuna mbeten kërcënime të vazhdueshme. Është koha për të vepruar me vendosmëri dhe për t'u mbështetur në progresin e arritur deri më tani, në mënyrë që çdo person në BE të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe të mund të jetojë me dinjitet dhe respekt."

Citim nga Komisionerja për Barazinë, Helena Dalli: "Gjetjet e anketimit të FRA-së ofrojnë të dhëna të vlefshme rreth përvojave jetësore të personave LGBTIQ në mbarë Evropën. Ato na ndihmojnë të identifikojmë progresin që kemi arritur, si dhe nxjerrin në pah sfidat që na presin përpara. Inkurajoj të gjitha shtetet anëtare që t'i përdorin të dhënat për të zhvilluar politika solide për të luftuar diskriminimin dhe për të mbrojtur të drejtat e të gjithë personave LGBTIQ."

Gjetjet e këtij anketimi bazohen në përgjigjet e mbi 100 000 të anketuarve nga të 27 vendet e BE-së, si dhe nga Shqipëria, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Serbia.

FRA do ta prezantojë raportin në eventin "[Pride Alliances and Policy](#)" (Aleancat dhe politika e lëvizjes "Pride"), të organizuar më 17 maj, në Bruksel, nga Presidenca belge e Këshillit të BE-së.

Platforma e FRA-së për eksplorimin e të dhënave do të mundësojë së shpejti filtrimin e të dhënave sipas vendit, pyetjes së anketimit, orientimit seksual, identitetit gjinor dhe shprehjes gjinore, si dhe karakteristikave të seksit.

Për më shumë informacion, konsultoni [paketën mediatike](#) ose kontaktoni: media@fra.europa.eu / Tel.: +43 1 580 30 653

Ky njoftim për shtyp është përkthyer nga Qendra e Përkthimit për Organet e Bashkimit Evropian, por nuk është korrigjuar nga ekspertët e FRA-së.